



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE

Nr. _____, Data: 31/01/2025.

Mitrovicë Veriore.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA MITROVICA E VERIUT - OPŠTINA SEVERNA MITROVICA			
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	10	Nr. Pril. Br. Pril. Prot. Nr.	10-030/01-000.124/25
Nr. i fjalëve St. stranice Words	15	Data Datum Date	31.01.2025

RREGULLORE KOMUNALE NR. 03/2025
PËR MENAXHIMIN E PARKINGJEVE PUBLIKE DHE SHËRBIMIN E
TRANSPORTIT ME 'MERIMANGË' NË TERRITORIN E KOMUNËS SË
MITROVICËS VERIORE

Janar 2025, Mitrovicë Veriore

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja c, nenin 17, paragrafi 1 shkronja f të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenin 7 paragrafi 1, nenet 89,90,91,92 dhe 93 të Ligjit nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor, nenin 7 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundervajtje, nenin 15 shkronja a dhe f të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, nenin 127,128,131 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe nenin 13 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Mitrovicës Veriore, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Veriore në mbledhjen e mbajtur me 31/01/2025, miratoi këtë:

RREGULLORE KOMUNALE NR. 03/2025
PËR MENAXHIMIN E PARKINGJEVE PUBLIKE DHE SHËRBIMIN E
TRANSPORTIT ME ‘MERIMANGË’ NË TERRITORIN E KOMUNËS SË
MITROVICËS VERIORE

DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është përcaktimi i kushteve dhe kriterëve të vendarkimeve publike dhe private, përcaktimin e zonave mënyrën e pagesës, çmimet dhe llojet e biletave për vendparkim, procedurën e paraparë për krijimin dhe operimin e parkingjeve private ,mënyrën e shfrytëzimit të tyre dhe mbikëqyrjen për parkimin e automjeteve në gjithë territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore , dhe shërbimin e transportit me “merimangë”.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Rregullore do të zbatohet në tërë teritorin e Komunës së Mitrovicës Veriore, dhe do të vlejë për të gjithë personat fizik dhe juridik që operojnë në këtë teritor.
Për zbatimin e kësaj Rregullore në bazë të kompetecave të tyre, përgjegjëse janë drejtoritë përkatëse në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.

Neni 3
Hapësirat e parkimit

Hapesira publike e parkimit është hapsirë e dedikuar për parkimin e automjeteve, e cila është e rregulluar si vendparkim, e shenjuar me shenja të komunikacionit (sinjalistikën vertikale dhe horizontale) dhe me informata rreth zones së parkimit. Këto hapësira përfshijnë segmentet të cilat janë pjesë e hapësirës publike të parkingut, hapësirën e mesme për qarkullim të automjeteve në parking, ishujt dhe oazat gjelbëruese, si dhe trotualet përreth parkingut.

Neni 4
Llojet e parkingjeve

1. Llojet e parkingjeve në kuptim të kësaj rregullore konsiderohen:

1.1 Vendparkimet publike me kohë të caktuar dhe paccaktuar, të cilat përfshijnë:

- 1.1.1 Vendparkimet përgjatë rrugëve publike dhe hapësirave të destinuara si vendparkime publike, në të cilat përfshihen edhe vendparkimet me laura të mbyllura, parkimin në parkingjet komerciale, parkimin në parkingjet për banorë rezidentë.
- 1.1.2 Vendparkimet/garazhet me PPP (partneritet publiko privat)
2. Parkingjet private.
- 2.1 Lejet për operimin e parkingjeve private i leshon Drejtoria e Sherbimeve Publike (me tutje DSHP),
- 2.2 Kriteret për operimin e parkingjeve private caktohen nga DSHP.
- 2.3 Revokimi i lejes së operimit apo cdo nderhyrjeje tjetër mund të bëhet nga DSHP duke u thirrur në nevojat dhe kërkesat e DSHP-se që janë me interes për realizimin e projekteve të komunës.
3. Cmimoret përcaktohen nga organi kompetent i Komunës (DSHP), duke u ndërlidhur me zonimin.

Neni 5 Vendparkimet

1. Vendparkime publike janë të gjitha vendparkimet përgjatë rrugëve publike dhe hapësirave të destinuara si vendparkime publike, që menaxhohen nga DSHP.
2. Hapësirat e vendparkimeve publike me vendim të veçantë nga Drejtoria për Sherbime Publike mund t'ju jepen në shfrytëzim institucioneve vendore, ndërkombëtare dhe diplomatike.
3. Vendparkimet me PPP- garazhet menaxhohen nga operatori privat, i perzgjedhur përmes procedurave të përcaktuara me ligj.
4. Vendparkimet private janë të gjitha ato vendparkime, të cilat i permbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga kjo rregullore, si në vijim:
 - 4.1. Certifikatën e biznesit për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse;
 - 4.2. Marreveshje apo kontratë e noterizuar me pronarin-et e ligjshëm për shfrytëzimin e hapësirës së caktuar si vendparkim;
 - 4.3. Projektin për kyçje dhe funksionet e hapësirës së vendparkimit, i hartuar nga inxhinieri i komunikacionit rrugor;
 - 4.4. Hapësira për vendparkim të ketë së paku 8 vendparkime;
 - 4.5. Kyçja të mos lejohet në rrugën e cila ka më tepër se dy shirita për kahje të njëjta të lëvizjes;
 - 4.6. Parkingu duhet të ketë qasje direkte në rrugë, jo të kalojë përmes trotuarit;
 - 4.7. Të ketë shenjëzim horizontal dhe vertikal;
 - 4.8. Shtrimin me kubze betoni, asfalt;
 - 4.9. Të ketë sistemin e kamerave.

Neni 6

Ushtrimi i veprimtarisë

1. Lejen për ushtrimin e veprimtarisë afariste të parkingjeve e leshon Drejtoria e Sherbimeve Publike, pas rekomandimit mbi plotësimin e kriterëve sipas nenit 5, paragrafit 3 të kësaj rregulloreje, nga ana e një komisioni të themeluar nga kryetari dhe i përbere nga përfaqësuesit e DSHP, DI dhe DU.
2. Afati i vlefshmërisë i Lejes së operimit i lëshuar sipas nenit 5, është (4) vite nga momenti i pajisjes me Leje të operimit.
3. Revokimi (heqja e së drejtës) i Lejes së operimit, mund të bëhet në cdo kohë kur konstatohet nga ana e Drejtorisë së Inspekcionit që subjekti përkatës nuk i është përmbajtur kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore.
4. Në momentin e pajisjes me leje si në nenin 5, paragrafi 5, operatori obligohet të pajiset me arkë fiskale.
5. Kuponi fiskal duhet të lëshohet për secilin shfrytëzues në momentin e fillimit të kohës së parkimit.
6. Taksa për dhënien e lejes si në nenin 5 do të jetë:
 - a. Për marrjen e Lejes së përgjithëshme të operimit, secili aplikues duhet të paguaj taksën e përgjithshme në vlerë prej 500.00 euro, dhe
 - b. Taksën vjetore për secilin vendparkim sipas ndarjes së mëposhtme:
 - i. ZONA I (qendra e qytetit) - 100.00 euro për një vendparkim;
 - ii. ZONA II - 50.00 euro për një vendparkim;
 - iii. ZONA III për një periudhë prej dy (2) vitesh prej hyjës në fuqi të kësaj rregulloreje do të lirohet nga kjo takse.
7. Përcaktimi i zonave është i përcaktuar në nenin 10 të kësaj rregullore.

Neni 7

Vendparkimet që Mbikqyren nga DSHP

1. Vendparkimet publike për banorë rezidentë;
2. Vendparkimet publike të përhershme apo të përkohshme, rrugore dhe jashtë rrugore si dhe cdo hapësirë tjetër publike e cila mund të shfrytëzohet si parking publik;
3. Vendparkimet e përkohshme publike në të cilat parkimi paguhet gjatë organizimit të përkohshëm të komunikacionit, gjatë organizimit të manifestimeve të ndryshme, ngjarjeve dhe të ngjashme:
 - 3.1 Vendparkimet rrugore publike të cilat gjenden në rrugë dhe trotuare, të shenjuara në mënyrë të veçantë me shenja horizontale dhe vertikale, në pajtim me dispozitat e Ligjit për

Rregullat e Trafikut Rrugor dhe me dokumentacion Teknik;

3.2 Vendparkimet jashtërrugore publike të cilat gjenden jashtë rruges dhe të shenjuara me shenjat vertikale dhe horizontale, e të cilat përcaktohen me projekt të veçantë.

Neni 8 Mënyra e përcaktimit të zonave të parkimit

1. Përcaktimi i saktë i zonave, si dhe i hapësirave të cilat mund të shfrytëzohen si hapësira të parkingut brenda këtyre zonave bëhet me aprovimin paraprak dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ana e një komisioni të themeluar nga kryetari dhe i përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë së Urbanizmit, Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Drejtorisë së Inspeksionit.
2. Për shtim të njësive të reja të vendparkimeve, për pronat komunale që kanë mundësi të shëndrohen në parkingje publike, është përgjegjëse DSHP.

Neni 9 Menaxhimi dhe klasifikimi i hapësirave të vendparkimeve publike

1. **Hapësira rezidenciale**, - është hapësirë e parkimit e përcaktuar për banorët rezident të adresës specifike. Vetëm banorët e adresës përkatëse, mund të parkohen në këto hapësira.
2. **Hapësire komerciale**, - e shënuar me sinjalizim vertikal është e përcaktuar për vizitorët dhe paguhet për çdo orë qëndrimi.
3. **Hapësire e kombinuar**, - është hapësirë e parkimit rrugor e cila mund të përdoret nga banorët rezident dhe vizitorët në oraret e përcaktuara nga DSHP me sinjalistike vertikale.

Neni 10 Zonat e parkingjeve

1. Vendparkingjet publike klasifikohen në zona:
 - 1.1. **ZONA I** (qendra e qytetit) përfshin hapësirën brenda dhe përgjatë perimetrit të unazës qendrore të kryeqytetit.
 - 1.2. **ZONA II** - hapësira që përfshihet nga përfundimi i zonës së parë (ZONA I), përgjatë dhe brenda unazës së brendshme të kryeqytetit.
 - 1.3. **ZONA III** - hapësira që përfshihet nga përfundimi i unazës së brendshme (ZONA II) deri në kufijt e zonës urbane.
2. Unaza qendrore dhe unaza e brendshme përcaktohen me dokumente të planifikimit hapësinor.
3. Zonimi/ndarja dhe përcaktimi i hapësirave publike të destinuara si vendparkingje publike, duhet të bëhet nga një komision i themeluar nga ana e kryetarit dhe i përbërë nga përfaqësuesit e DSHP, DU, DI.

Neni 11 Sinjalizimi horizontal dhe vertikal

1. Parkingjet janë sipërfaqe për parkimin e automjeteve, të cilat përbëhen nga një apo me shumë vende të parkimit. Vendparkimet duhet të jenë të sinjalizuara (vertikalisht dhe horizontalisht) me qëllim që automjetet të mund të parkohen në hapësira parkimi sipas dimensioneve si në vijim: (të barten nga UA për normat teknike të planifikimit hapësior MMPH-08/2017).

1.1. Vendparkimi në 90° - 250 cm X 455 cm, gjerësia e kalimit 550 cm për lëvizje një ose dykahore;

1.2. Vendparkimi në 60°- 250 cm X 485 cm, gjerësia e kalimit 470 cm për lëvizje njëkahore dhe 550 cm për lëvizje dykahore;

1.3. Vendparkimi në 45°- 250 cm X 485 cm, gjerësia e kalimit 350 cm për lëvizje njëkahore dhe 550 cm për lëvizje dykahore;

1.4. Vendparkimi në 30° - 250 cm X 425cm, gjerësia e kalimit 350cm për lëvizje njëkahore dhe 550 cm për lëvizje dykahore;

1.5. Vendparkimi në 0° - 215 cm X 640 cm, gjerësia e kalimit 350 cm për lëvizje njëkahore dhe 550 cm për lëvizje dykahore;

1.6. Vendparkimi i rrethuar - 270 cm X 550 cm;

2. Vendet për parkim shënohen me vija në gjerësi prej 12 cm. Vendet e veçanta të parkimit (për invalidë, vende të rezervuara) shënohen me ngjyrë të kalter.

3. Vendosja e shenjave horizontale/vertikale të trafikut në vendparkingjet publike që gjenden nën menaxhimin e DSHP, bëhet nga vet DSHP.

Neni 12

Kushtet e përgjithshme të parkimit

1. Personat që kanë të drejtë në shfrytëzimin e vendparkingjeve publike pajisen me kartë të parkimit të caktuar për automjet, e cila duhet të përmbajë afatin e vlefshmërisë dhe e cila vlen vetëm për adresën në të cilën është regjistruar.

2. Të gjitha automjetet që shfrytëzojnë parkingjet e menaxhuara duhet të jenë me regjistrim valid, me police sigurimi, si dhe të kenë të kryera kontrollet teknike. Automjetet që nuk plotësojnë kushtet e qarkullimit rrugor nuk mund të parkohen në vendparkingjet e menaxhuara nga DSHP.

Neni 13

Aplikimi për shfrytëzimin e vendparkimit

1. Të gjithë personat fizik dhe juridik kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë për shfrytëzimin e vendparkingut në zonën ku jetojnë, punojnë apo ushtrojnë veprimtarinë e tyre, duke paguar çmimin e përcaktuar sipas çmimoreve së miratuar nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës Veriore.

2. Në rast të ndërrimit të targave/automjetit, personat që kanë aplikuar për shfrytëzimin e parkingjeve duhet të njoftojnë drejtorinë përkatëse për ndryshimet e bëra.

Neni 14
Mënyra e pagesës së çmimit për parkim

1. Për shfrytëzimin e parkingut, shfrytëzuesi është i obliguar të paguajë çmimin e parkimit, varësisht nga koha e shfrytëzimit të vendparkimit dhe zones në të cilën gjendet vendparkimi.
2. Çmimi propozohet nga një komision i themeluar nga ana e kryetarit dhe i përbërë nga përfaqësuesit e DSHP, DU, DI, dhe i miratuar nga Kuvendi Komunal.
3. Shfrytëzuesi është i obliguar të paguajë çmimin e parkimit për çdo orë të filluar të shfrytëzimit.
4. Shfrytëzuesi është i obliguar të respektojë kohën e lejuar për parkim.
5. Mënyra e pagesës së parkimit, do të përcaktohet nga ana e drejtorisë përmes një akti të brendshëm.

Neni 15
Llojet e biletave

1. Biletat e rregullta të parkimit janë:
 - 1.1 Biletat orëshe
 - 1.2 Biletat ditore
 - 1.3 Biletat mujre dhe vjetore të parkimit

Neni 16

Shfrytëzimi i parkingjeve

1. Përdoruesi i parkimit brenda kuptimit të dispozitave të kësaj rregullore konsiderohet vozitësi ose pronari i një automjeti.
2. Pagesa e parkimit në Zonën I, Zonën II dhe Zonën III bëhet konform çmimoreve të miratuara nga ana e KK Mitrovicës Veriore.
3. Përdoruesi i parkingut është i obliguar që:
 - 3.1. të përdorë vendin e parkimit në përputhje me sinjalizimin e trafikut, vertikal dhe horizontal, me të cilin është shënuar vendi i parkimit;
 - 3.2. të veprojë në përputhje me kufizimin e kohës së shfrytëzimit të hapsirave të parkimit të përcaktuara sipas kësaj rregullore;
 - 3.3. të paguajë përdorimin e hapsirave të parkimit sipas kohës së mbajtjes, dhe çmimit të përcaktuar;
 - 3.4. deri në skadimin e kohës së parkimit të paguar dhe në përputhje me këtë rregullore ta largojë automjetin nga parkingu.
4. Për çdo lloj ndryshimi apo rrethane të ardhshme që lidhet me vendparkingjet publike, komuna obligohet të njoftojë së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara qytetarët mbi ndryshimet eventuale

që lidhen me vendparkimin, menyrën e pagesës, shfrytëzimin e prakingut dhe informatat tjera.

Neni 17

Kategoritë e liruara nga obligimi i pagesës për parkim

1. Nga obligimi për pagesën e shfrytëzimit të vendparkingjeve, lirohen kategoritë si në vijim:
 - 1.1. Veturat zyrtare të Komunës së Mitrovicës Veriore;
 - 1.2. Veturat diplomatike;
 - 1.3. Personat me aftësi të kufizuara ose personi shoqërues i tij;
 - 1.4. Automjetet zyrtare të shërbimeve emergjente (automjetet me targa të policisë, zjarrfikësit dhe shërbimet shëndetësore).
2. Për inkuadrim në sistem të veturave të liruara, obligohen aplikuesit që të paraqesin në DPSH dokumentacionet si në vijim:
 - 2.1. Kopje të Lejes së vlefshme të qarkullimit të automjetit, për të gjithë paragrafët nga 1.1 deri në 1.4 të këtij neni;
 - 2.2. Dokumentet mjekësore sipas një procedure të brendshme të Drejtorisë përgjegjëse për aplikimet sipas paragrafit 1.3 të këtij neni.

Neni 18

Ndalesat e parkimit të automjeteve

1. Parkimi dhe ndalimi i automjetit në kundërshtim me shenjat e trafikut, sinjalizimi horizontal dhe vertikal.
2. Parkimi i automjetit pa kryer pagesën për shfrytëzim të vendparkingut.
3. Në rrugë, në vende, përkatësisht në hapësira të destinuara për ndalje dhe parkim, edhe në sipërfaqet e ndërtuara të komunikacionit të parapara për lëvizjen e këmbësorëve, nuk lejohet lënia e mjeteve, të cilat nuk përdoren në komunikacion (të papërdorura, të paregjistruara ose të ngjashme) ose mjetet bashkëngjitëse, të cilat shfrytëzohen vetëm përkohësisht (rimorkio e lehtë ose kamp-shtëpiza, ose të ngjashme), sendet, materialet dhe të ngjashme të cilat pengojnë rrjedhën normale të komunikacionit apo e ndotin ambientin.
4. Parkimi dhe ndalimi i automjeteve në hapësirat e parkimit për personat me aftësi të kufizuar, si dhe në vende të rezervuara për parkim nëse përdoruesi nuk i përket kategorive të përmendura.
5. Parkimi i një automjeti që nuk i përket kategorisë së automjeteve për të cilin është planifikuar parkimi.
6. Parkimi i automjeteve për kohë më të gjatë se koha e parashikuar për parkim në zonën e dhënë.
7. Nxënia e parkingjeve duke vendosur rrethoja ose pengesa të ngjashme pa pëlqimin e organit kompetent të komunes.
8. Shfrytëzimi i parkimeve publike për qëllime biznesore të aktivitetit të taksive, si dhe të aktivitetit të qiradhënies së makinave.

9. Parkimi i automjeteve komerciale, makinerisë së rëndë, automjeteve të punës, kamp-shtëpizave, rimorkio, traktorëve, makineri bujqësore, autobusëve, minibusëve, furgonëve, përveç në rastet kur kanë leje specifike nga drejtoritë përkatëse të Komunës së Mitrovicës Veriore për të kryer shërbime të ngarkim/shkarkimit apo në aktivitete të kontraktuara dhe të pajisura me leje të punës nga Komuna e Mitrovicës Veriore.

II. SHËRBIMI I TRANSPORTIT ME MERIMANGË

Neni 19

Transporti me "merimangë"

1. Shërbimi i transportit me "merimangë", nënkupton tërheqjen - bartjen e automjeteve të mara nga vendet ku është i ndaluar parkimi i tyre, nga vendet ku ka ndodhur aksidenti në komunikacion, automjetet që mund të jenë të braktisura dhe në raste të tjera, dhe vendosja e tyre në vendin e caktuar për këtë qëllim.
2. Pas konstatimit të shkeljes së rregullave në komunikacion, të evidentuar nga personat kompetent, se automjeti është ndaluar apo parkuar në mënyrë jo të rregullt, ai tërhiqet në bazë të urdhërësës së zyrtarit policor dhe kërkesës së personit të autorizuar nga organi i Komunës së Mitrovicës Veriore.
3. Para se të jepet urdhëresa për zhvendosjen e automjetit, sipas paragrafit paraprak të këtij neni, pozita e automjetit të ndaluar ose parkuar në mënyrë jo të rregullt, dëshmohet me fotografi ose me skicë.
4. Vendin (lokacionin) për vendosjen e automjeteve në autopark, nga paragrafi paraprak, e cakton Kuvendi i Komunes (për pronë publike) si dhe përmes procedurave prokurimit për (pronat private).

Neni 20

Ofrimi i shërbimit

1. Operatori i transportit me "merimangë" do të caktohet përmes ankandit të shpallur apo procedurave tenderuese për kryerjen e shërbimeve të transportit me "merimangë", në bazë të kushteve më të volitshme të ofruara.
2. Ndërmarrja biznesore e licencuar nga Komuna dhe operatori i përzgjedhur përmes procedurave ligjore për zhvendosjen e automjeteve duhet t'i ketë edhe paisjet për bllokimin e automjeteve.

Neni 21

Lidhja e kontrates

1. Komuna do të lidhë kontratë me operatorin e përzgjedhur të transportit-fituesin e ankandit për transport me "merimangë", me të cilin do t'i përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese.
2. Kontrata nga paragrafi paraprak, lidhet për kohë të caktuar deri në (3) vite me mundësi vazhdimi.

Neni 22

Zhvendosja dhe bllokimi

1. Tërheqja - bartja e automjeteve bëhet me urdhër dhe nën kontrollin e Policisë, apo inspektorit komunal të komunikacionit duke konstatuar gjendjen e automjetit, para se të lëshohet urdhëresa për tërheqje.
2. Automjetet e ndaluara ose të parkuara në mënyrë jo të rregullt zhvendosen, ndërsa autobusët, automjetet transportuese, makinat dhe automjetet e punës dhe rimorkiot, bllokohen dhe tërhiqen në bazë të urdhëresës së zyrtarit policor dhe kërkesës së personit të autorizuar nga organet e Administratës komunale: inspektoriat i Komunikacionit apo inspektoriat komunal, në bashkëpunim me Policinë.
3. Automjeti që kërkohet të tërhiqet nga pronari (drejtuesi i automjetit), sipas nenit 2.1 të kësaj Rregullorje, në afatin prej gjashtë muajsh nga dita e vendosjes në atë vend me ligj, neni 10.1, automjeti do të shitet në ankand publik dhe të hollat do të derdhen në Buxhetin e konsoliduar të Komunës.
4. Nëse automjeti pas tri ankandeve publike nuk mund të shitet, ai duhet të asgjësohet në bazë të vendimit, të cilin e nxjerr një komision i veçantë, i cili formohet nga Komuna, Policia e Kosovës dhe Dogana e Kosovës.

Neni 23

Lirimi i automjetit nga autoparku

1. Në momentin e tërheqjes-marrjes së automejtit nga operatori, përveç dëshmisë së pagesave, operatori duhet të kërkoj edhe dëshminë e pronësisë ose evidencën, se personi që kërkon lëshimin e automjetit ka qenë duke drejtuar ata para se të bllokohej, përkatësisht para se të jetë tërhequr në vendin e caktuar për këtë.

Neni 24

Obligimet dhe përgjegjësitë e operatorit

1. Operatori është përgjegjës të plotësojë të gjitha dokumentet e nevojshme gjatë kryerjes së sigurimit fizik të autoparkut të Komunës.
2. Afati për sigurimin e autoparkut zgjatë derisa zgjatë kontrata e tërheqjes (autobartjes)
3. Operatori është përgjegjës në rast keqperdorimi, demtimi eventual gjatë ngarkimit - shkarkimit, bartjes deri në dorëzimin e automjetit në autopark (demin eventual të shkaktuar duhet t'ia kompensojë pronarit të automjetit).
4. Pas dorëzimit dhe vendosjes së automjetit në autopark, përgjegjësia bie mbi personelin e sigurimit të autoparkut deri të bëhet tërheqjen e automjetit nga pronari apo personi i autorizuar.

Neni 25

Kushtet për shërbimin e transportit me "merimangë"

Shërbimi i transportit për "merimangë" duhet të jetë i licencuar.

Kushtet për licencim janë:

1. të jetë i regjistruar ne Komunen e Mitrovices Veriore per ushtrimin e sherbimit të transportit me "merimangë", në teritorin e të njejtës.
2. të ketë së pakut dy (2) automjete për bartjen e automjeteve,
3. te ketë sistemin funksional të komunikimt,
4. të sigurojë shërbimin 24/7 në javë,
5. të ketë së paku njëzet (20) bllokues rrotash me ngjyrë të verdhë,
6. të ketë numër të mjaftueshëm të personelit për ushtrimin e veprimtarisë.
7. të ketë zyre administrative (me seli në Komunën e Mitrovicës Veriore)
8. të ketë vend parkimin për vendosjen e automjeteve (të dëshmuar me listë posedues ose kontratë mbi shfrytzimin).

Neni 26

Kushtet për automjetet bartëse

1. Automjetet duhet:
 - 1.1 të jenë të regjistruara në Komunën e Mitrovicës Veriore,
 - 1.2 të jenë të dedikuara posaqerisht për bartjen e automjeteve,
 - 1.3 të jenë teknikisht në rregull në çdo kohë,
 - 1.4 të kenë paisjet e parapara për ushtrimin e kësaj veprimtarie,
 - 1.5 të kenë dritën rrotulluese me ngjyrë të verdhë të vendosur mbi automjet
 - 1.6 të kenë shenjat përkatëse të komunikacionit.

Neni 27

Kushtet për drejtuesit e automjeteve

1. Drejtuesit e automjeteve merimangë duhet:
 - 1.1 të jenë në marrëdhënie pune të operatori,
 - 1.2 të kenë patentën e shoferit të kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit përkatës,
 - 1.3 të kenë ndihmësin për kryerjen e bartjes.

Neni 28

Shpenzimet e zhvendosjes se mjetit

1. Shpenzimet e zhvendosjes së mjetit dhe të qëndrimit të mjetit në vendin e caktuar i bartë shoferi, përkatësisht pronari i mjetit.
2. Shumën e shpenzimeve të zhvendosjes së mjeteve e përcakton Policia në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse për Financa.
3. Tarifa e shpenzimeve për zhvendosjen e automjeteve, bllokimit dhe zhblokimit, si dhe ruajtja në vendin ku vendosen, është e përcaktuar si ne vijim :
 - 3.1 Për zhvendosjen e motoçikletës, traktorit dhe veturës pa rimorkio brenda qytetit, deri në vendin për vendosje dhe ruajtjen e tyre deri në 24 orë, tarifa e shpenzimeve është e tridhjetë (30) €.
 - 3.2 Tërheqja e automjetit transportues, rimorkios ose gjysme rimorkios dhe autobusit brenda qytetit, deri në vendin për vendosje dhe ruajtja e tyre deri në 24 orë, kushton njëqind (100) €.

3.3 Zhvendosja e automjeteve nga zona jashtë qytetit, pa ngarkese, kushton 0.25 € për 1 km, ndërsa me ngarkese 0.50 € për 1 km.

3.4 Ne rastin kur zhvendosja e automjetit vetëm fillon, por nuk bëhet zhvendosja deri në vendin e ruajtjes, zbatohet çmimi si vijon: në zonën urbane 15 €, ndërsa jashtë zones urbane zbatohet pika 3.3.

3.5 Kur automjeti i zhvendosur, pas kalimit të kohës prej njëzetekatër orësh, nuk merret nga pronari ose shfrytëzuesi, siç përcaktohet në këtë Rregullore, ruajtja, përkatësisht qëndrimi i mëtutjeshëm i automjetit për një ditë qëndrimi dhe ruajtje, do të paguhet çmimi prej 5 €.

3.6 Për zhbllokimin e automjeteve, të autobusëve, të automjeteve transportuese, automjeteve të punës dhe rimorkiove, duhet paguar 15 €.

3.7 Kur automjeti i bllokuar, pas kalimit të kohës prej njëzetekatër orësh, kur pronari ose shfrytëzuesi i automjetit nuk përmbush detyrimet për zhbllokimin e automjetit siç përcakton kjo Rregullore, ruajtja, përkatësisht qëndrimi i mëtutjeshëm i automjetit nën bllokim, për një ditë qëndrimi dhe ruajtje duhet paguar 5 €.

3.8 Të gjitha pagesat nga paragrafi paraprak do të bëhen përmes bankës, si të hyra të Komunës;

3.9 Taksat e shërbimeve do t'i vërtetojë Drejtoria e Financave.

3.10 Për secilën pagesë do të lëshohet fatura, e cila do të jete me numër rendor dhe do të përmbajë këto të dhëna:

- markën dhe modelin e automjetit,
- numrin e targave,
- emrin e plotë, adresën dhe numrin personal të personit që i lirohet automjeti,
- datën e bllokimit të automjetit,
- datën e lirimit të automjetit dhe vendin e lirimit (në vendqëndrimin e Automjeteve apo në vendin ku është bllokuar).

Neni 29 Puna me bllokues

1. Sipas kësaj Rregullore, operatori i licencuar nga Komuna duhet të jetë i pajisur me bllokues.
2. Sistemi i vendosjes së bllokuesve kryhet nga punëtorët e operatorit, në marrëveshje me policinë, në cdo kohë dhe në çdo vend.
3. Automjetit të cilit i vendosen bllokuesit, duhet të paguaj tarifën sipas nenit 28, paragrafi 3 pika 3.6 të kësaj Rregullore.
4. Në rast se pronari, përkatësisht drejtuesi i automjetit largon automjetin para se të arrijnë punëtorët për vendosjen e bllokuesve, ai paguan tarifën sipas nenit 28, paragrafi 1 i kësaj Rregullore.

Neni 30 Lirimi nga tarifa e pagesave

1. Nga pagesa lirohen:
 - 1.1 Automjetet e zhvendosura ose automjetet që tërhiqen me rastin e konfiskimit nga ana e Policisë, me qëllim të verifikimit të dokumentacionit dhe të automjetit, në rast se verifikimi rezulton i rregullt;

- 1.2 Automjetet e zhvendosura ose që tërhiqen, në rastet kur automjeti ka pësuar aksident dhe si pasojë ka ardhur deri te vdekja e personave në automjet dhe
- 1.3 Automjetet e tërhequra nga Policia për shkaqe sigurie.
2. Si dëshmi e plotësimit të këtyre kriterëve të paragrafit paraprak, Policia, gjatë plotësimit të raportit, duhet shënuar arsyen e tërheqjes - marrjes së automjetit.
3. Nëse me vendim të Gjykatës verifikohet rregullsia e dokumentacionit dhe automjetit të konfiskuar nga ana e Policisë, të cilin dokument pronari ose shfrytëzuesi i automjetit duhet ta sjellë me rastin e ushtrimit të kërkesës për lirim e automjetit.

Neni 31 **Mbikqyrja e operatorit**

Drejtoria (personi i autorizuar i DSHP) do t'i kontrollojë në vazhdimësi të dhënat e operatorit lidhur me shërbimet e bëra, pajisjet, sigurimin e objektit, listën mujore të tërheqjes dhe vendin për parkim. Drejtoria ka të drejtën e kontrollit të dhënave edhe pas skadimit apo të ndërprerjes së kontratës, në periudhë prej 3 (tre) vitesh.

Neni 32 **Automjetet e braktisura**

1. Automjetet e braktisura, të cilat shihet se nuk janë në gjendje të rregullt teknike, kur i mungojnë pjesët qenësore të automjetit (pa motor, goma, parafango etj.), zhvendosen me urdhëresën e zyrtarit policor pas kërkesës së zyrtareve të Komunës (inspektoreve komunal dhe komunikacionit), këto automjete zhvendosen në depon e mbeturinave metalike.
2. Shpenzimet e zhvendosjes së automjetit në depon e mbeturinave metalike i bart pronari i fundit i automjetit, nëse kjo mund të konstatohet në bazë të të dhënave të regjistrimit të automjetit nga evidenca e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në të kundërtën, bie në barrë të Komunës, zyrtaret e së cilës bëjnë kërkesën për zhvendosje.
3. Para se të behet zhvendosja e automjeteve të braktisura, operatori i licencuar nga Komuna për zhvendosjen e automjeteve, përmes ekspertit përkatës, konstaton vlerën reale kushtuese të automjetit.

Neni 33 **Shkëputja e kontratës**

Në rast të shkeljes së ndonjëres nga dispozitat e kësaj Rregulloreje, Drejtoria mban të drejtën e shkëputjes së kontratës me operatorin.

Neni 34 **Shqiptimi i gjobave**

Drejtoria e inspeksionit është e autorizuar për shqiptimin e gjobave që ndërlidhen me shkeljet në vijim:

1. Per shkeljet e parapara në nenin 18, paragrafi 1 dhe 4, personit fizik dhe personit përgjegjës i personit juridik, do t'i shqiptohet gjobë per kundërvajtje në shumë prej tridhjetë (30) euro, ndërsa per personin juridik njëqind (100) euro.
2. Per shkeljet e parapara në nenin 18, paragrafi 8, personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në shumë prej njëqind (100) euro, ndërsa për personin juridik pesëqind (500) euro.
3. Nëse personi juridik operon pa leje për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse sipas kësaj rregulloreje, do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në shumë prej njëqind e pesëdhjetë deri në dhjetë mijë 1000.00 euro.
4. Operatorit publik ose privat i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje varësisht nga shkelja e konstatuar në shumë prej njëqind e pesëdhjetë deri në një mijë (150 - 1.000) euro.
5. Operatorit publik ose privat, i ndalohet që të kryejë shërbime të riparimit ose shërbime të largjes së automjeteve, apo aktiviteteve tjera që ndikojnë në funksionimin normal të parkimit, të njëjtit do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në shumë prej njëqind e pesëdhjetë deri në një mijë e pesëqind (150- 1.500) euro.
6. Nëse inspektori konstaton se operatori publik apo privat përsërit shkeljet e përshkruara më lart deri në tri herë e më tepër, do të iniciohet procedurë për revokimin e lejes.
7. Për ushtrimin e kompetencave të përcaktuara me këtë nen të kësaj rregulloreje, me qëllim të kryerjes së detyrave të punës me efikasitet, Drejtoria e Inspekcionit ka të drejtë që të kërkojë ndihmë nga operatori, në mbarëvajtjen dhe lirin e hapësirave publike nga parkingjet ilegale.

Neni 35 **Procedura sipas ankesës**

1. Qytetarët e komunës në cdo kohë mund të ushtrojnë ankesë në Drejtorinë e Inspekcionit vetëm për çështjet, të cilat ndërlidhen me kompetencat e kësaj drejtorie.
2. Në rast të ushtrimit të ankesës nga qytetarët në Drejtori të Inspekcionit, sikur që është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, kompetent për vendosjen e çështjes do të jetë drejtoria e Inspekcionit.
3. Të gjitha ankesat tjera që nuk janë pjesë e autorizimeve të Drejtorisë së Inspekcionit, palët duhet t'i drejtohen DSHP-së.
4. Ankesa kundrejt urdhëresës për tërheqje me “merimangë”:
 - 4.1 Kundër urdhëresës për zhvendosje ose bllokim të automjeteve, pronari ose poseduesi i automjetit ka të drejtë ankese.
 - 4.2 Ankesa parashtrohet brenda afateve ligjore të parashikuara me ligj, ndaj autoriteteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 19 të kësaj rregullore.
 - 4.3 Nëse ankesa miratohet si e bazuar, ankuesit do t'i behet kompensimi i shumës se paguar

për zhvendosje ose bllokimin e automjetit, sipas dispozitave të parapara që rregullojnë këtë lëmi.

Neni 36 Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen e zbatimit të rregullores e kryen Drejtoria kompetente e inspektionit në komunë, e cila gjatë mbikëqyrjes inspektuese është e obliguar dhe kompetente të mbikëqyrë:
 - 1.1. Lejen e operimit të secilit parking publik dhe privat;
 - 1.2. Përbushjen ose jo të kriterëve të përcaktuara me nenin 4 të kësaj rregullore lidhur me parkingjet private, si dhe dispozitat tjera që ndërlidhen me kriteret për operimin e parkingjeve publike;
 - 1.3. Rregullsinë e përgjithshme teknike të parkingjeve publike dhe private;
 - 1.4. Kontrollimin e procedurave të ndjekura nga ana e zyrtarëve përgjegjës të komunës;
 - 1.5. Kontrollimin e implementimit të çmimoreve së miratuar nga Kuvendi Komunal.
 - 1.6. Kontrollimin nëse parkingjet publike dhe private përgjithësisht operojnë në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore;
- 1.7. Të urdhërojë operatorin për mënjanimin e mangësive të evidentuara gjatë inspektimit brenda një afati të caktuar.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 37

Për të gjitha çështjet tjera, të cilat nuk janë paraparë në këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 08/L-186, për Rregullat e Trafikut Rrugor, dhe dispozitat e Ligjit Nr 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, Ligji nr. 05/L-087 për Kundervajtje.

Neni 38 Hyrja ne fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse.

Mitrovicë Veriore

Nedžad UGLJANIN

Kryesues i Kuvendit në Komunën e Mitrovicës Veriore

Dorëzohet:


1x1 Kryesuesit të Kuvendit

1x1 MAPI,

1x1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës
Të gjitha Drejtorive





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë	
Kopje:	Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës Veriore Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbilin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor në MAPL	Data: 03.03.2025 VI-0-64
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Ramadan Potera, Zyrtar për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Shkresë përfundimtare për MD	
Lloji i aktit:	Rregullore	

E nderuar Sekretare,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar rregulloren komunale nr. 03/2025 për menaxhimin e parkingjeve publike dhe shërbimin e transportit me "merimangë" në territorin e komunës së Mitrovicës Veriore, i miratuar nga kuvendi i komunës së Mitrovicës Veriore dhe i nënshkruar nga kryesuesi i kuvendit të komunës së Mitrovicës Veriore, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Rregulloren komunale nr. 03/2025 për menaxhimin e parkingjeve publike dhe shërbimin e transportit me "merimangë" në territorin e komunës së Mitrovicës Veriore.

I miratuar më datë: 31.01.2025

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.02.2025

Të nderuar

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në tekstin e mëtejshëm MMPHI) , duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr.08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe Plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe në bazë të kompetencave ligjore të Ministris të përcaktuar me ligjet bazike si dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, shtojca 1 pika 10, Departamenti Ligjor (në tekstin e mëtejshëm: DL) nga MALP-ja ka pranuar kërkesën për shqyrtimin ligjshmërisë ashtu siç parashihet me Nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, aktin e komunës sin ë vijim:

Rregulloren Nr.03/2025 për Menaxhimin e Parkingjeve Publike dhe Shërbimin e Transporti me „ Merimangë,, në Territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore.

MMPHI-ja, pas shqyrtimit të përmbajtjes dhe analizimit të *Rregullores Nr.03/2025* për Menaxhimin e Parkingjeve Publike dhe Shërbimin e Transporti me „ Merimangë,, në Territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore, e miratuar në KK Mitrovica Veriore , konsiderojmë se kjo rregullore prek fushat e dy ose më shumë ministrive , andaj MMPHI ka vlerësuar ligjshmërin e Rregullores, sa përket fushëveprimtarisë së Infrastrukturës.

Raporti për finalizimin e Ligjshmërisë së *Rregullores, Nr. 03/2025 për Menaxhimin e Parkingjeve Publike dhe Shërbimin e Transporti me „ Merimangë,,* në Territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore

Arsyetimi

MMPHI-ja pas shqyrtimit të përmbajtjes dhe analizimit të Rregullores Komunale *Nr.3/2025* për Menaxhimin e Parkingjeve Publike dhe Shërbimin e Transporti me „ Merimangë,, në Territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore, miratuar në KK Mitrovicën Veriore, si dhe duke marrë parasysh se kompetencat e nivelit Qendror dhe lokal janë të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, si dhe në bazë të vlerësimit profesional të departamentit përkatës, gjegjësisht D.PSH „ ku ka cekur se „ Sa i përket Ligjit Nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor, është në rregull kjo Rregullore, nëse i përmbahet Nenit 28 , paragrafi 2 ku cekët se „Shumën e shpenzimeve të zhvendosjes së mjeteve e përcakton Policia në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse për Financa“, e që është në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e nenit 93, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor.



Andaj, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe rekomandimin e Departamentit për Patentë Shofer dhe Automjete, konsiderojmë se Rregullorja është në harmoni me legjislacionin nga fushëveprimtaria e MMPHI (pjesa e Infrastrukturës).

Në fund, theksojmë se sa i përket çështjes së dispozitave për kundërvajtje të përcaktuar në këtë Rregullore se a janë të harmonizuara me Ligjin për Kundërvajtje mund ti drejtoheni Ministrisë së Drejtësisë.

MMPHI, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarë do sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt



Visar Syla

From: Ramadan Potera
Sent: Monday, March 24, 2025 9:19 AM
To: Erden Atiq; Edis Ahmeti; Nedzad Ugljanin; Visar Syla
Subject: FW: Rregulloren komunale Nr.03/2025 KK Mitrovicë Veriore.
Attachments: 0-64-3-2025.pdf

Vlersimi I Rregullores nga MMPHI

Me respekt

From: Erblin Hetemi
Sent: Monday, March 24, 2025 8:52 AM
To: Ramadan Potera <Ramadan.Potera@rks-gov.net>
Cc: Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>
Subject: Fwd: Rregulloren komunale Nr.03/2025 KK Mitrovicë Veriore.

Dergoja komunes..

Sent from my iPhone

Begin forwarded message:

From: Floriana Rugova <Floriana.Rugova@rks-gov.net>
Date: 21 March 2025 at 15:20:11 CET
To: Ramadan Potera <Ramadan.Potera@rks-gov.net>, Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>
Cc: Anita Kalanderi <Anita.Kalanderi@rks-gov.net>, Jeton Qela <jeton.qela@rks-gov.net>, Erblin Hetemi <erblin.hetemi@rks-gov.net>, Feride Podvorica <Feride.Podvorica@rks-gov.net>
Subject: FW: Rregulloren komunale Nr.03/2025 KK Mitrovicë Veriore.

Të nderuar/a

Ministria e Drejtësisë me datën 4 Mars 2025 ka pranuar Rregulloren Komunale Nr.03/2025 për menaxhimin e parkingjeve publike dhe shërbimin e transportit me "merimangë" në territorin e komunës së Mitrovicës Veriore për taksa, të miratuar më datën 31.01.2025 dhe të parashtruar për shqyrtim në MAPL më datën 03.02.2025 (më tej: Rregullorja).

Ministria e Drejtësisë, bazuar në mandatin dhe fushën e përgjegjësisë administrative të saj, që prek këtë Rregullore, ju njofton si në vijim:

Rregullorja përmban dispozita të natyrës ndëshkimore penale, respektivisht kundërvajtje dhe sanksione kundërvajtëse me gjobë, të cilat janë në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.